



**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**  
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**  
**DREJTORIA E KURRIKULËS DHE E KUALIFIKIMIT**

## **MODELE TESTESH PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR**

*(Teste të hartuara nga mësuesit)*

### **LËNDA “DITURI NATYRE”**



**TETOR, 2019**

## **PËRMBAJTJA**

HYRJE .....	3
ARSIMI FILLOR.....	4
TEST PËRMBLEDHËS 1 .....	4
TEST PËRMBLEDHËS 2 .....	10
TEST PËRMBLEDHËS 3 .....	15
TEST PËRMBLERDHËS 4 .....	21
TEST PËRMBLEDHËS 5 .....	30

## **HYRJE**

ASCAP-i ka mbështetur mësuesit gjatë gjithë procesit të zbatimit të kurrikulës së re që bazohet në kompetenca. Në këtë kuadër janë hartuar materiale ndihmëse për mësuesit, kryesisht për procesin e planifikimit, të mësimdhënies dhe të vlerësimit. Një aspekt me rëndësi për vlerësimin e nxënësit është hartimi i testit. Kurrikula e re kërkon nga mësuesit që, në të gjithë procesin e vlerësimit (përfshirë edhe testin), të vlerësojnë kompetencat. Kjo risi është sfidë për mësuesit, sidomos hartimi i testit me pyetje ose kërkesa që synojnë të vlerësojnë nivelin e arritjeve të kompetencave.

Për t'u ardhur në ndihmë mësuesve është hartuar ky material, në të cilin ofrohen disa modele testesh për lëndën dituri natyre. Për hartimin e tyre ka punuar një grup pune, i cili është i përbërë nga mësues të të gjitha cikleve, specialistë të kurrikulës në ASCAP dhe specialistë të vlerësimit në QSHA. Këto modele janë përpjekje të mësuesve për të hartuar teste të cilat synojnë të vlerësojnë kompetencat. Ato janë sugjeruese dhe kanë për qëllim t'u vijnë në ndihmë mësuesve në hartimin e testeve të periudhave.

## ARSIMI FILLOR

**Alketa Bulku**

**Shkolla “Gustav Majer”**

### TEST PËRMBLEDHËS 1

*Klasa IV*


Tabela e specifikimeve

Njohuritë	Përqindja = Pikët	Rezultatet e të nxënit  Nxënësi:	: Niveli II i arritjes së komp.	Niveli III i arritjes së komp.	Niveli IV i arritjes së komp.
Sistemet te kafshët	64% = 21 pikë	emërton kockat kryesore në trupin e njeriut;	U1		
Mbështetja dhe lëvizja		tregon se skeleti ndërtohet nga kocka të cilat te njeriu dhe disa kafshë rriten brenda trupit;	U2		
Kockat e skeletit		përshkruan se si kockat e skeletit rriten, mbështesin dhe mbrojnë trupin;		U 6	
		tregon se muskujt punojnë në çifte;		U 3	
Muskujt		tregon se një muskul duhet të tkurret që të shkaktojë lëvizjen e kockës;		U4	
		tregon se kafshët kanë muskuj të lidhur me kockat.		U5	

Ilaçet		shpjegon rolin e drogave si ilaçe.	U7		
Qeniet e gjalla në mjediset e tyre	36 % =	diskuton për bimë dhe kafshë që jetojnë në habitate të ndryshme për tipare me të cilat ata përshtaten me mjedisin ku jetojnë.		U8	U 9
Përshtatjet në mjedis	12 pikë				
Ndikimi i njeriut në mjedis			diskuton mënyrat me të cilat veprimtaria e njeriut ndikon në habitate lokale.		
Çelësat e përcaktimit		demonstron përdorimin e një çelësi të thjeshtë përcaktimi p.sh. për të identifikuar një specie të panjohur të gjetur në mjedisin përreth.		U 10	
	<b>100%= 33 pikë</b>		<b>40% = 12 pikë</b>	<b>40% = 15 pikë</b>	<b>20% = 6 pikë</b>

## TEST PËRMBLEDHËS

1. Në figurën e mëposhtme është paraqitur skeleti i njeriut. Përcakto në figurë (duke shënuar me shigjetë llojin e kockës) një kockë të sheshtë, një kockë të gjatë dhe një kockë të shkurtër. (3 pikë)



2. Lidh pjesët e fjalive. (4 pikë)

Rruaza është	skelet brenda trupit.
Kafshët që nuk kanë skelet	206 kocka.
Njerëzit kanë	një kockë në shtyllën kurrizore.
Skeleti ynë përbëhet nga	quhen jorruazorë.

3. Si e kuptojmë shprehjen “muskujt punojnë në dyshe”? (2 pikë)

4. E vërtetë apo e gabuar? Qarko përgjigjen. (5 pikë)

- a. Kockat mund të lëvizin vetë.  
V      G
- b. Ne rritemi sepse skeleti ynë rritet.  
V      G

c. Marrja me tepri e barnave nuk na sëmur.

V G

d. Kafshët nuk përshtaten me mjedisin ku jetojnë.

V G

e. Të gjithë shpendët janë kafshë mishngrënëse.

V G

5. Ngjyros me të njëjtën ngjyrë pjesën e skeletit me organin që mbron. (3 pikë)

kafazi i kraharorit

truri

kafka

palca kurrizore

shtylla kurrizore

zemra dhe mushkëritë

6. Në klasën e Jonës erdhi një shoqe e re. Ajo është me aftësi ndryshe. Ndodhet në karrocë me rrota se s'mund të ecë. Ajo u tregoi shokëve se në një aksident kishte dëmtuar shtyllën kurrizore. Si mendoni, pse dëmtimi e ka shkaktuar këtë? (2 pikë)

---

---

---



7. Përshkruaj me fjalët e tua shprehjen: çdo ilaç është drogë por jo çdo drogë është ilaç. (2 pikë)

---

---

---

8. Vëzhgo me kujdes figurat. Shpjego përse shpendët i kanë këto 2 cilësi: gishtat me tejeza, sqepin e gjatë ose të kthyer? (2 pikë)



---

---

---

---

9. Lexo reflekto.

(3 pikë)

Kohët e fundit, në të gjithë botën po ndodh një katastrofë e heshtur, ZHUKJA E BLETEVE. Askush nuk e di pse po ngordhin bletët dhe fundi i tyre është shumë afër ; në Angli rreth 1/3 e bletëve ka ngordhur. Siç e dimë, bletët bëjnë pllenimin e luleve duke bërë të mundur krijimin e frutave. Ky është një proces që mund të bëhet vetëm nga insektet dhe në 80% të rasteve nga bletët, *sepse do të ishte e pamendushme që të bëhej nga dora e njeriut.* **Ky është një kërcënim që i bëhet të gjithë njerëzimit.** Si e kuptoni, a mendoni se nga zhdukja e bletëve rrezikon njerëzimi?

---

---

---

---

10. Blerta mësoi për \_\_\_\_\_ e përcaktimit. :

(4 pikë)


Nisur nga përgjigjet që i bëri Bleta Reit, ai dha këto përgjigje:

Ka 2 këmbë, jeton në ujë, \_\_\_\_\_.

Ka 4 këmbë, trupin me qime, bisht \_\_\_\_\_

Nuk ka këmbë, ka guaskë \_\_\_\_\_.

Identifikoni cili prej tyre ishte: një pinguin, një ketër, një pulë, një zhapik apo kërmill?



11. Trego përmes tre shembujve si mund ta mbrojtë njeriu mjedisin. (3 pikë).

---

---

---



## Vlerësimi

<b>Nota</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>10</b>
<b>Pikët</b>	<b>0-8</b>	<b>9-12</b>	<b>13-16</b>	<b>17-21</b>	<b>22-25</b>	<b>26-29</b>	<b>30-33</b>

Alketa Bulku

Shkolla : “Gustav Majer”

## TEST PËRMBLEDHËS 2

Klasa IV

Tabela e specifikimeve

Njohuritë	Përqindja = Pikët	Rezultatet e të nxënit Nxënësi:	: Niveli II i arritjes së komp.	Niveli III i arritjes së komp.	Niveli IV i arritjes së komp.	
ENERGJIA Tingulli <ul style="list-style-type: none"><li>Burimet e tingullit</li><li>Përhapja e tingullit</li></ul> Karakteristikat e tingullit	58% = 19 pikë	shpjegon se tingujt prodhohen nga burime të ndryshme;  a) përhapet nga një burim dhe dëgjohe kur arrin në veshin tonë; b) përhapet përmes një mjedisi lëndor; c) përhapet përmes materialeve të ndryshme lëndore (trupa të ngurtë, lëngje dhe gaze);  b) dobësohet kur largohemi nga burimi që e prodhon atë	U 1			
		dallon tingujt e fortë nga tingujt e butë;		U 5	12b	
		krahason volumin e një tingulli me forcën e tingullit që e shkakton atë;				12 a
		tregon si prodhohen tingujt nga instrumentet frymore;		U11		
		mat nivelin e tingullit me njësinë matëse decibel (db).		U6		
Ndryshimet e gjendjes së lëndëve	28 % = 9 pikë	identifikon dhe përshkruan dallimet ndërmjet lëndëve të lëngëta, të ngurta dhe të gazta;	U3			

Proceset e shkrirjes, ngrirjes, avullimit dhe kondensimit					
		vëzhgon dhe krahason trupa të ndryshëm sipas gjendjes së tyre;		U 2	
		heton dhe shpjegon tretjen e lëndëve dhe ndikimin e temperaturës në tretje;		U 8	
		heton dhe vëzhgon proceset e vlimit, avullimit dhe kondensimit të ujit;	U9		
Gjendjet e lëndës	15 % = 5 pikë	hulumton dhe përshkruan mënyrën se si lëndët ndryshojnë kur nxehen dhe kur ftohen;			U 7
Lëndët dhe vetitë e tyre		heton dhe përshkruan shndërrimin e lëndëve dhe ndikimin e temperaturës në to;		U 10	
Përzierjet e lëndëve					
Procesi i tretjes					
	<b>100%= 33 pikë</b>		<b>40% = 14 pikë</b>	<b>40% = 14 pikë</b>	<b>20% = 5 pikë</b>

## TEST PËRMBLEDHËS

1. Emërto të paktën dy përbërës të ajrit \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_. 2 ( pikë)

2. Plotëso tabelën për të treguar nëpërmjet grimcave gjendjet e lëndës. 3 ( pikë)

Gjendja e lëndës	Trup i ngurtë	Lëng	Gaz
Vizato si ndodhen grimcat në çdo lëndë.			


3. Shoqëro 3 ( pikë)

- Lëngjet ndryshojnë formën ● ● sepse grimcat nuk e ndryshojnë pozicionin e tyre.  
Gazet nuk kanë formë ● ● sepse grimcat lëvizin larg njëra tjetrës.  
Trupat e ngurtë ruajnë formën ● ● sepse grimcat rrëshkasin kundrejt njëra tjetrës.

4. Qarko **V** ( e vërtete ) ose **G** ( e gabuar). 4 ( pikë)

- a) Çdo trup që lëshon tingull quhet burim tingulli. V G  
b) Tingulli përhapet më mirë aty ku nuk ka material. V G  
c) Trupat që lëshojnë tinguj nuk dridhen. V G  
d) Tingulli përhapet përmes materialeve të ndryshme. V G

5. Klasifiko 5 (pikë)



6. Lidh fjalën me kuptimin përkatës: 4 ( pikë)

- zhurmëmbytësi është njësia që përdoret për matjen e tingullit

dridhjet                                      është një veçori që varet nga shpejtësia e dridhjeve  
lartësia e tingullit                      janë lëvizjet para - mbrapa të lëndës  
decibeli                                      janë materiale që pengojnë përhapjen e zhurmave


7. Mira dhe Bledi ikën në plazh. Ata kishin marrë me vete ushqime dhe lëngje. Ata u lanë në det dhe kur dolën shkuan për të ngrënë. Çokollata ishte shkrirë, buka ishte lagur se ishte ngjitur me bidonin e ftohtë të ujit. Bledi që është në klasë të 4-rt i shpjegoi Mirës së vogël pse kishin ndodhur këto. Si mendon, çfarë i tha Bledi Mirës?

2 ( pikë)

---

---

8. Në figurën e mëposhtme jepen tri gjendjet e ujit. Shëno temperaturat për secilën gjendje të ujit brenda katrorit në figurë.                                      2 (pikë)



9. A e dallojmë një tretësirë me sheqer nga një tretësirë me kripë pa e provuar? Pse?                                      2 (pikë)

10. Në figurën e mëposhtme jepen tre instrumente muzikore. Përcaktoni cili prej tyre është instrument me goditje, me frymë dhe me tela:                                      3 ( pikë)



a) \_\_\_\_\_



b) \_\_\_\_\_



c) \_\_\_\_\_

11. Plotëso fjalinë duke gjykuar nga situata.

3 ( pikë)

Aeroplani krijon zhurmë më të fortë se makina sepse:

\_\_\_\_\_

Ne e dëgjojmë zhurmën e aeroplanit më pak kur nuk jemi në pistë për shkak të:

\_\_\_\_\_

Në hapësirë nuk dëgjohet tingulli sepse

\_\_\_\_\_

### Vlerësimi

<b>Nota</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>10</b>
<b>Pikët</b>	<b>0-8</b>	<b>9-12</b>	<b>13-16</b>	<b>17-21</b>	<b>22-25</b>	<b>26-29</b>	<b>30-33</b>

**Alketa Bulku**

**Shkolla : “Gustav Majer”**

### **TEST PËRMBLEDHËS 3**

*Klasa IV*

Tabela e specifikimeve

Njohuritë /konceptet	Përqindja = Pikët	Rezultatet e të nxënit	Niveli II i arritjes së komp.	Niveli III i arritjes së komp.	Niveli IV i arritjes së komp.
Elektriciteti dhe magnetizmi	100% = 33 pikë	shpjegon se elektriciteti rrjedh në qarqet elektrike;	U 1		
Qarku elektrik		paraqet përmes një vizatimi të thjeshtë lëvizjen e orientuar të thërmijave në qarkun elektrik;		U 10 a	
Elementet përbërëse të qarkut të thjeshtë elektrik		tregon se rryma elektrike është lëvizja e thërmijave nga poli pozitiv i burimit në polin negativ;	U 3a, c		
Qarqet me shumë elemente		përkthyer elementet përbërëse të një qarku të thjeshtë elektrik (pilë/burim, fije përcjellëse, llamba elektrike) dhe rolin e secilit prej tyre;	U 2	U10b	
Elektriciteti dhe përdorimet e tij		shpjegon se një pajisje elektrike nuk punon në qoftë se ka shkëputje në qark;		U4	
		shpjegon se ndriçimi i llambave në qark zvogëlohet, kur shtojmë numrin e llambave në të dhe anasjellas;			U8
		shpjegon se llambat dhe zilet e lidhura në qark punojnë brenda një vlere të		U 12	

Magnetët Polet magnetike të një magneti  Vetitë magnetike të metaleve		përcaktuar rryme;			
		dallon përcjellësit nga jopërcjellësit;	U 11		
		tregon si zbatohen rregullat e sigurisë gjatë punës me pajisjet elektrike për t'u mbrojtur nga rreziqet e mundshme;			U 13
		përshkruan karakteristikat e magnetëve	U 5		
		identifikon polet e një magneti; shpjegon se forcat e bashkëveprimit magnetik kanë karakter shtytës ose tërheqës;		U3b	U 6
		krahason vetitë magnetike të metaleve.		U3d, U7	
	100% = 33 pikë		40% = 15 pikë	40% = 12 pikë	20% = 6 pikë



## TEST PËRMBLEDHËS

1. duhet fjalët **elektricitet, pila, rrymë elektrike, rrjedh.** Plotëso ku (4 pikë)




Elektriku i dorës punon sepse \_\_\_\_\_ e tij prodhojnë \_\_\_\_\_.  
Elektriciteti \_\_\_\_\_ në një drejtim të caktuar, këtë lëvizje e quajmë \_\_\_\_\_.

2. Emërto të paktën dy përbërës të një qarku elektrik \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_. 2 ( pikë)

3. Lidh fjalën me kuptimin përkatës: 4 (pikë)

- |                                 |    |   |   |
|---------------------------------|----|---|---|
| a) Tensioni i një burimi tregon | •  | • | janë forca vepruese                       |
| b) Forcat magnetike             | •  | • | duhet të sigurojnë tension të mjaftueshëm |
| c) Burimet e rrymës në qark     | •• | • | sa i fuqishëm është burimi.               |
| d) Hekuri dhe çeliku janë       | •  | • | materiale magnetike                       |

4. Shëno me shenjen  $\checkmark$  në cilin prej qarqeve do të ndriçojë llamba. Pse ? 3 ( pikë)



---

---

---

5. Klasifiko . 5 (pikë)

Magnetikë

kopsa plastike  
vida celiku

Jomagnetikë

gozhdë hekuri  
tel bakri  
lugë alumini

6. Shpjego se çfarë do të ndodhë me magnetët e paraqitur në figurën 1 dhe në figurën 2  
2(pikë)



Figura 1




Figura 2



7. Cili nga pohimet është i saktë.

1 ( pikë)

- a) Të gjitha metalet janë magnetike.
- b) Vetëm hekuri është magnetik.
- c) Hekuri dhe çeliku janë magnetike.

8. Ku do të ndriçojë më shumë llamba? Shpjegoni pse?

2 ( pikë)



---

---

---

9. Nëse kemi 3 pila 1.5 V dhe na duhet një burim 6V, sa pila duhet të bashkojmë? Pse ?

2 (pikë)

---


---

10. a. Në figurën e mëposhtme vendos shigjetat në drejtim nga duhet të rrjedhë rryma.

1 (pikë)

b. Emërto pjesët përbërëse të qarkut të paraqitur në figurë.

4 (pikë)



11. Çfarë quajmë përcjellës?

1 (pikë)

---

---

12. Shiko me vëmendje dy pilat në figurën e mëposhtme! Trego çfarë kanë të ndryshme këto pila?

1 (pikë)



13. Që nga ditëlindja kur ia kishin sjellë Robotin, Dea nuk e kishte vënë më në punë. Kur provoi ta ndizte, ai bëri një zhurmë të lehtë dhe nuk lëvizi. Si mendoni pse nuk punon Roboti ?

2 (pikë)

## Vlerësimi

<b>Nota</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>10</b>
<b>Pikët</b>	<b>0-8</b>	<b>9-12</b>	<b>13-16</b>	<b>17-21</b>	<b>22-25</b>	<b>26-29</b>	<b>30-33</b>

## TEST PËRMBLERDHËS 4

Klasa V

Periudha III

Mësuesja: Ermira Fishta

Shkolla “Ernest Koliqi”, Tiranë

Tematika: Toka dhe hapësira

Nëntematika: Trupat qiellorë

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

*Ndërtimi i tabelës së specifikimit. Mësuesi duhet të përcaktojë numrin e kërkesave, që duhet të përmbajë testi në përputhje me kohën e realizimit të tij. Koha e plotë duhet të jetë 45 minuta, pra 1 orë mësimore. Duke patur parasysh nivelet e arritjeve të rezultateve të të nxënit sipas kompetencave lëndore dhe peshat e përcaktuara sipas niveleve ndërtojmë tabelën e BLUE printit. Për nivelin 2, testi përmban 40% të kërkesave të përgjithshme të tij, Për nivelin 3, testi përmban pra 40% të kërkesave të përgjithshme të tij, për nivelin 4, testi përmban 20% të kërkesave të përgjithshme të tij.*

Njohuritë dhe konceptet	Peshat në %	Rezultatet e të nxënit	N <sub>2</sub>	N <sub>3</sub>	N <sub>4</sub>
Dielli, Toka dhe Hëna	50%	<p><b>shpjegon</b> se Dielli është një yll në qendër të sistemit diellor;</p> <p><b>tregon</b> se Hëna rrotullohet rreth Tokës dhe është satelit natyror i saj;</p> <p><b>tregon</b> se Dielli, Toka dhe Hëna janë trupa sferikë;</p> <p><b>argumenton</b> se Dielli nuk lëviz, por duket sikur lëviz për shkak të rrotullimit të Tokës rreth vetes dhe rreth Tij;</p> <p><b>shpjegon</b> pse Dielli është</p>	<p>U<sub>2</sub> = 1 pikë</p> <p>U<sub>6</sub>= 1 pikë</p>	<p>U<sub>21</sub> = 1 pikë</p> <p>U<sub>16</sub> = 1 pikë</p>	

		<p>burimi kryesor i energjisë;  <i>shpjegon</i> se Dielli është burimi kryesor i dritës;  <i>shpjegon</i> pse Dielli lind në mëngjes dhe perëndon në mbrëmje;  <i>shpjegon</i> se ora e lindjes dhe perëndimit të Diellit ndryshon çdo ditë gjatë vitit;  <i>tregon</i> se Toka është i vetmi planet i njohur deri tani si planet që ka jetë;  <i>tregon</i> se Toka është një planet që ka vetëm një satelit natyror, Hënën;  <i>tregon</i> se Hëna rrotullohet rreth Tokës;  <i>tregon</i> se Toka rrotullohet rreth Diellit për 365 e ¼ ditë;  <i>tregon</i> se Galaktika ku ndodhet planeti ynë Toka quhet Rruga e qumështit;  <i>tregon</i> se astronomët përdorin teleskopin për të zbuluar të rejtat e Universit.</p>	<p><math>U_{7/a} = 1</math> pikë</p> <p><math>U_{7/d} = 1</math> pikë</p> <p><math>U_{24/d} = 1</math> pikë</p> <p><math>U_{18} = 1</math> pikë</p> <p><math>U_{24/b} = 1</math> pikë</p> <p><math>U_{20} = 1</math> pikë</p>	<p><math>U_{24/a} = 1</math> pikë</p> <p><math>U_9 = 1</math> pikë</p>	<p><math>U_6 = 1</math> pikë</p> <p><math>U_{15} = 1</math> pikë</p> <p><math>U_{17} = 1</math> pikë</p>
Rrotullimi i Tokës	10%	<i>tregon</i> se Toka rrotullohet rreth	$U_1 = 1$		

rreth boshtit të saj		<p>boshtit të saj nga perëndimi në lindje;</p> <p><b>tregon</b> se rrotullimi i Tokës rreth boshtit të saj zgjat 1 ditë dhe 1 natë;</p> <p><b>përshkruan</b> formimin e ditës dhe natës si pasojë e rrotullimit të Tokës rreth boshtit të saj;</p>	<p>pikë</p> <p><math>U_4 = 1</math></p> <p>pikë</p>		<p><math>U_{14} = 1</math></p> <p>1 pikë</p>
Rrotullimi i Tokës rreth Diellit	10%	<p><b>shpjegon</b> se Toka kryen një rrotullim të plotë rreth Diellit sipas një orbite për 356 e <math>\frac{1}{4}</math> ditë;</p> <p><b>përshkruan</b> formimin e stinëve si pasojë e rrotullimit të Tokës rreth Diellit;</p> <p><b>tregon</b> se forma e rrotullimit të Tokës rreth diellit është eliptike;</p>	<p><math>U_{18} = 1</math></p> <p>pikë</p>		<p><math>U_{13} = 1</math></p> <p>1 pikë</p> <p><math>U_{14} = 1</math></p> <p>1 pikë</p>
Planetët e jashtëm dhe të brendshëm	30%	<p><b>emërton</b> planetin më afër Diellit;</p> <p><b>emërton</b> planetin më afër Tokës;</p> <p><b>përcakton</b> grupin e planetëve të brendshëm;</p> <p><b>përcakton</b> planetët e jashtëm;</p> <p><b>emërton</b> planetin e brendshëm</p>		<p><math>U_3 = 1</math></p> <p>pikë</p> <p><math>U_5 = 1</math></p> <p>pikë</p> <p><math>U_9 = 1</math></p> <p>pikë</p> <p><math>U_{10} = 1</math></p> <p>pikë</p> <p><math>U_{11} =</math></p>	

		afër Diellit;  <i>emërton</i> planetin e brendshëm më të largët nga Dielli;  <i>emërton</i> planetin më të largët nga Dielli;  <i>tregon</i> se planetët e pasqyrojnë dritën e Diellit;  <i>shpjegon</i> se të gjithë planetët rrotullohen rreth Diellit;		1 pikë  $U_{12} =$ 1 pikë  $U_{22} =$ 1 pikë  $U_{7.c.} =$ 1 pikë	
			$U_{7/d} = 1$ pikë		
<b>Gjithsej</b>			<b>12 pikë</b>  <b>40%</b>	<b>12pikë</b>  <b>40%</b>	<b>6pikë</b>  <b>20%</b>

*Shënim:* Testi nuk duhet të jetë as shumë i vështirë dhe as shumë i lehtë, sepse ul besueshmërinë e tij dhe nuk realizon vlerësimin objektiv të nxënësve. Niveli më i përshtatshëm i vështirësisë arrihet atëherë kur rezultati i pikëve është në intervalin (50-60) %.



## TEST PËRMBLEDHËS

1. Toka rrotullohet rreth boshtit të saj nga: 1 pikë
- A) Veriu në Jug
  - B) Perëndimi në Lindje
  - C) Jugu në Veri
  - D) Lindja në Perëndim
2. Trupi që ndodhet në qendër të sistemit diellor është: 1 pikë
- A. Toka
  - B. Hëna
  - C. Dielli
  - D. Jupiteri
3. Cili planet është më pranë Diellit: 1 pikë
- A) Toka
  - B) Plutoni
  - C) Marsi
  - D) Mërkuri
4. Një ditë dhe një natë në Tokë zgjasin: 1 pikë
- A) 10 orë
  - B) 12 orë
  - C) 16 orë
  - D) 24 orë
5. Cili planet është më pranë Tokës: 1 pikë
- A) Jupiteri
  - B) Mërkuri
  - C) Neptuni
  - D) Marsi
6. Pse Dielli është burimi kryesor i energjisë? 1 pikë
- A. Energjia diellore ndryshon nga një formë në një formë tjetër.
  - B. Dielli lëshon dritë dhe ngrohtësi të domosdoshme për jetën në Tokë.
  - C. Dielli është në qendër të sistemit diellor.
  - D. Në mungesë të Diellit, Toka do të ishte në errësirë të plotë.

7. Plotëso fjalinë me një nga fjalët e mëposhtme: 4 pikë  
planetët/ pasqyrojnë/i katërti/ Toka/  
a. .... është i vetmi planet i njohur deri tani në të cilin ka jetë.  
b. Marsi është .....planet afër Diellit.  
c. Planetët dhe Hënat e tyre .....dritën e Diellit.  
d. Të gjithë..... rrotullohen rreth Diellit.
8. Rrethoni nga alternativat e mëposhtme grupin e katër planetëve të brendshëm: 1 pikë  
A. Merkuri Afërdita, Toka, Neptuni  
B. Marsi, Toka, Afërdita, Merkuri  
C. Marsi, Afërdita, Toka, Saturni  
D. Jupiteri, Saturni, Plutoni, Neptuni
9. Cili nga planetët e mëposhtëm ka vetëm një hënë: 1 pikë  
A. Merkuri  
B. Afërdita  
C. Toka  
D. Marsi
10. Cili nga planetët e mëposhtëm Nuk është i brendshëm: 1 pikë  
A. Merkuri  
B. Marsi  
C. Urani  
D. Afërdita
11. Planet i brendshëm më afër Diellit është: 1 pikë  
A. Afërdita  
B. Merkuri  
C. Toka  
D. Marsi
12. Planet i brendshëm më i largët nga Dielli është: 1 pikë  
A. Afërdita  
B. Merkuri  
C. Toka

- D. Marsi
13. Cila dukuri lidhet me rrotullimin e Tokës rreth Diellit: 1 pikë
- A. Formimi i katër stinëve
  - B. Formimi i ditës dhe natës
  - C. Viti kalendarik
  - D. Ndryshimi i formës së hënës
14. Cila është forma e rrotullimit të Tokës rreth Diellit: 1 pikë
- A. Eliptike
  - B. Rrethore
  - C. Zig-zag
  - D. Vijë e drejtë
15. Pse Dielli lind në mëngjes dhe perëndon në darkë çdo ditë: 1 pikë
- A) Për shkak të rrotullimit të Diellit rreth vetes
  - B) Për shkak të rrotullimit të Tokës rreth Diellit
  - C) Për shkak të rrotullimit të Tokës rreth boshtit të saj
  - D) Për shkak të rrotullimit të Diellit rreth Tokës
16. Shpjegoni pse Dielli, edhe pse nuk lëviz, neve na duket sikur lëviz. 1 pikë
- 
- 
17. Ora e lindjes dhe perëndimit të Diellit: 1 pikë
- A. Ndryshon çdo ditë gjatë vitit;
  - B. Nuk ndryshon gjatë gjithë vitit;
  - C. Dielli lind në ora 8.00 të mëngjesit dhe perëndon në ora 20.00 të darkës.
  - D. Dielli lind në ora 7.00 të mëngjesit dhe perëndon në ora 19.00 të darkës.
18. Toka kryen një rrotullim të plotë rreth Diellit sipas një orbite për : 1 pikë
- A. 356 e  $\frac{1}{4}$  ditë;
  - B. 24 orë;
  - C. 30 ditë;
  - D. 7 ditë
19. Cila dukuri lidhet me rrotullimin e Tokës rreth boshtit të saj: 1 pikë

- A. Formimi i katër stinëve
- B. Formimi i ditës dhe natës
- C. Viti kalendarik
- D. Ndryshimi i formës së hënës

20. Cilin nga mjetet e mëposhtme përdorin astronomët për të zbuluar të rejtat e Universit:

1 pikë

- A. Mikroskopin
- B. Teleskopin
- C. Dylbitë
- D. Asnjë nga tre të parat

21. Hëna është:

1 pikë

- A. Satelit
- B. Planet
- C. Asteroid
- D. Yll

22. Cili nga planetët e mëposhtëm është më i largët nga Dielli:

1 pikë

- A. Mërkuri
- B. Afërdita
- C. Toka
- D. Neptuni

23. Dielli, Toka, Hëna janë trupa:

1 pikë

- A) Sferikë
- B) Satelitë
- C) Planetë
- D) Planetë shkëmborë

24. Nga fjalët e mëposhtme zgjidhni përgjigjen për secilën kërkesë:

4 pikë

*Rruga e qumështit, Dielli, Toka, Hëna*

- a. Rreth kujt rrotullohet Hëna?
- b. Si emërtohet Galaktika ku bën pjesë planeti ynë?
- c. Cili nga trupat qiellorë të mësipërm është burim drite?
- d. Cili është sateliti natyror i Tokës?

**Skema e konvertimit të pikëve në nota dhe përqindje:**

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-11	12-15	16-20	21-24	25-27	28-30
Përqindja e pikëve	< 25%	25- 40%	40-55%	55-70%	70-85%	85 -95	95-100%

# TEST PËRMBLEDHËS 5

Klasa V

Periudha II

Mësuesja: Kostanca Zadeja

Shkolla “Salo Halili”, Shkodër

Tematika: Energjia

Nëntematika: Drita dhe përhapja e saj

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Njohuritë dhe konceptet	Peshat në %	Rezultatet e të nxënit	N <sub>2</sub>	N <sub>3</sub>	N <sub>4</sub>
Burimet e dritës	20%	<i>emërton</i> burimet natyrore të dritës (Dielli, yjet, vullkanet, etj.); <i>emërton</i> burimet artificiale të dritës (llamba elektrike, qiri, llambat e dorës, etj.);	$U_{1/a,b,d} =$ 3 pikë $U_{1/c} = 1$ pikë	$U_{2/c} =$ 1 pikë $U_{2/d} =$ 1 pikë	
Drita dhe errësira Hija dhe ndryshimet e saj	80%	<i>tregon</i> se errësira është mungesa e dritës; <i>tregon</i> vlerën e shpejtësisë së dritës në zbrazësi; <i>përshkruan</i> se hija formohet kur drita bllokohet nga një trup i ngurtë;	$U_{12/b} =$ 1 pikë $U_{12/a} =$ 1 pikë	$U_{10} =$ 1 pikë	$U_{3/a} =$ 1 pikë $U_{3/d} =$ 1 pikë

	<p><i>tregon</i> se këndi i rënies së rrezeve të dritës është i barabartë me këndin e pasqyrimit;</p> <p><i>tregon</i> mënyrat si mbrohet syri nga drita e fortë e Diellit;</p> <p><i>tregon</i> faktorët që dëmtojnë syrin nga drita e fortë e Diellit;</p> <p><i>shpjegon</i> se ne shohim ngjyrën e një trupi, pasi ai i përthith të gjitha ngjyrat e tjera përveç ngjyrës së tij, e cila pasqyrohet në syrin tonë;</p> <p><i>klasifikon</i> sipërfaqet e tejdrukshme;</p> <p><i>klasifikon</i> sipërfaqet jo të tejdrukshme;</p> <p><i>analizon</i> vetinë e sipërfaqeve të ashpra, të cilat e përthithin dritën;</p> <p><i>shpjegon</i> se prizmi prej qelqi zbërthen dritën e bardhë.</p>	<p><math>U_4 = 3</math> pikë</p> <p><math>U_5 =</math> 3 pikë</p>	<p><math>U_8 =</math> 2 pikë</p> <p><math>U_9 =</math> 2 pikë</p> <p><math>U_{11} =</math> 2 pikë</p> <p><math>U_{2/a} =</math> 1 pikë</p> <p><math>U_{2/b} =</math> 1 pikë</p> <p><math>U_{7/d} =</math> 1 pikë</p>	<p><math>U_{12/c} =</math> 1 pikë</p> <p><math>U_{3/b,c} =</math> 2 pikë</p> <p><math>U_6 =</math> 1 pikë</p>
<b>Gjithsej</b>		<b>12 pikë</b> <b>40%</b>	<b>12pikë</b> <b>40%</b>	<b>6pikë</b> <b>20%</b>

## TEST PËRMBLEDHËS

1. Shkruani (V) për pohimet e vërteta dhe (G) për pohimet e gabuara: 4 pikë

- a. Dielli është burim natyror i dritës. (.....)
- b. Hëna është burim natyror i dritës. (.....)
- c. Llamba elektrike nuk është burim artificial i dritës. (.....)
- d. Xixëllonjat janë burim natyror i dritës. (.....)

2. Lidh fjalët me pohimet e mëposhtme që shpjegojnë kuptimin e tyre: 4 pikë

- |           |   |
|-----------|---|
| 1. Dielli | A. Trup i përbërë nga material, që e lejon të depërtojë dritën.     |
| 2. Xhami  | B. Trup i përbërë nga material, që nuk e lejon të depërtojë dritën. |

- |                     |                              |
|---------------------|------------------------------|
| 3. Llamba elektrike | C. Burim natyror i dritës    |
| 4. Druri            | D. Burim artificial i dritës |

3. Shpjegoni vërtetësinë e pohimeve të mëposhtme: 4 pikë

a) Ne nuk mund të shohim objektet që ndodhen në një dhomë të errët. Pse?

---

b) Pse xhami është trup transparent?

---

c) Trupat e ndodhur pas një xhami ne mund t'i shohim qartë. Pse?

---

d) Pse shkaktohet hija?

---

4. Listoni tre trupa të tejdukshëm ose lëndë të tejdukshme: 3 pikë

- a. \_\_\_\_\_
- b. \_\_\_\_\_
- c. \_\_\_\_\_

5. Listoni tre trupa jo të tejdukshëm ose lëndë jo të tejdukshme: 3 pikë

- a. \_\_\_\_\_



- b. \_\_\_\_\_
- c. \_\_\_\_\_

6. Plotësoni fjalinë me një nga alternativat e mëposhtme: 1 pikë

Ne vëzhgojmë zbërthimin e dritës me anë të një..... Ky trup ka aftësinë ta zbërthejë dritën e bardhë kur ajo bie mbi të në të gjitha ngjyrat e ylberit.

- A. Mikroskop
- B. Teleskop
- C. Prizëm prej qelqi
- D. Pasqyrë

7. Cili nga pohimet e mëposhtme **nuk** është i vërtetë: 1 pikë

- A. Prizmi prej qelqi zbërthen dritën e bardhë në ngjyrat e ylberit.
- B. Drita, pasi pasqyrohet, bie në syrin tonë dhe ne shohim trupat.
- C. Pasqyrat na ndihmojnë ne të shohim trupat pas nesh.
- D. Sipërfaqet e ashpra nuk e përthithin dritën;

8. Cilat janë dy mënyrat për të mbrojtur syrin tonë nga rrezet e Diellit: 2 pikë

- a. \_\_\_\_\_
- b. \_\_\_\_\_

9. Cilët janë dy faktorët që e dëmtojnë syrin tonë nga rrezet e Diellit: 2 pikë

- a. \_\_\_\_\_
- b. \_\_\_\_\_

10. Shpejtësia e dritës ka vlerën më të madhe kur përhapet në: 1 pikë

- A. Zbrazësi
- B. Metal
- C. Dru
- D. Ujë

11. Pse bluza perceptohet nga syri ynë me ngjyrë të kuqe? 2 pikë

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

12. Plotësoni fjalitë e mëposhtme me fjalët e duhura:

3 pikë

a. Hija formohet kur .....blikohet nga një trup i ngurtë.

b. Errësira është mungesa e .....

c. Drita pasqyrohet nga pasqyra me të njëjtin ..... që bie mbi pasqyrë.

**Skema e konvertimit të pikëve në nota dhe përqindje:**

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-11	12-15	16-20	21-24	25-27	28-30
Përqindja e pikëve	< 25%	25- 40%	40-55%	55-70%	70-85%	85 -95	95-100%